



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2015





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2015



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Qershor, 2016

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

Para thënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) është duke zhvilluar Anketën mbi Buxhetin e Ekonomive Familjare (ABEF), prej vitit 2002.

Qëllimi i publikimit të rezultateve të ABEF 2015, është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me konsumin, të ardhurat, si dhe të dhëna statistikore për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2013-2015 dhe kushtet e jetesës për periudhat 2014-2015.

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABEF-it, kanë ofruar Organizata Suedeze (SIDA) si dhe Banka Botërore (BB). Falënderojmë ekspertët e këtyre organizatave për kontributin e tyre. Nga stafi tjetër i ASK-së në nivel rajonal, falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale që kanë kontribuar në grumbullimin e të dhënave të ABEF .

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net.

Publikimin përgatitën:

1. Dr. sc. Bashkim Bellaqa – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Naime Rexhepi – Shefe e divizionit të Statistikave Sociale,
3. Emina Deliu – Shefe e sektorit të statistikave të Standardit Jetësor,
4. Besa Haqifi – Zyrtare e lartë e statistikave të Standardit Jetësor,
5. Hydai Morina – Zyrtar i statistikave të Standardit Jetësor dhe
6. Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajnim.

Qershor, 2016

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	-	Banka Botërore
BE	-	Bashkimi Evropian
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve Konsumuese
KKIQ	-	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
LLK	-	Llogaritë Kombëtare
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Bashkëpunim
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

Faqe

H Y R J E.....	5
1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2013 - 2015.....	6
1.1 Trendët e konsumit.....	6
1.2 Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit	7
2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2013–2015.....	8
2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha)	9
2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike	9
2.3 Banimi.....	10
2.4 Transporti.....	11
2.5 Veshmbathjet.....	11
2.6 Alkooli dhe duhani	12
2.7 Mobiliet.....	13
2.8 Shëndetësia.....	13
2.9 Komunikimi.....	14
2.10 Rekreacioni.....	14
2.11 Arsim.....	15
2.12 Hotele dhe restorante	15
2.13 Mallrat dhe shërbime tjera	16
3 Të hyrat private në Kosovë 2014 -2015	17
3.1 Të hyrat kryesore të ekonomive familjare	17
3.2 Burimet e të hyrave individuale	18
3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore.....	20
4 Kushtet e jetesës dhe Përballueshmëria	21
4.1 Pronësia sipas strukturës gjinore dhe nën hipotekë	21
4.2 Posedimi i dhomave dhe pajisjeve / shërbimeve.....	21
4.3. Përballueshmëria	23
5 Konkluzione	26
6 Shtojcat.....	27
6.1 Tabela A1: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2013-2015 sipas lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % e konsumit të përgjithshëm	27
6.1 Tabela A2: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2013-2015, sipas 5 grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në % (vazhdim).....	28
6.2 Metodologjia në të shkurtër	29

H Y R J E

ABEF është një vrojtim statistikor që kryhet për të marrë të dhëna mbi shpenzimet për konsum, vetë konsum, të ardhurat e familjeve dhe kushtet bazë socio-ekonomike në të cilin familjet jetojnë. Anketa siguron gjithashtu të dhëna mbi disa tregues të rëndësishëm në lidhje me kushtet e jetesës (banimin, posedimin e pajisjeve afatgjata në familje, kushtet e ngrohjes, udhëtimet dhe/ose pushimet vjetore), si edhe të dhëna mbi karakteristikat bazë demografike, ekonomike dhe sociale të familjeve.

Të dhënat e mbledhura nga ABEF do të sigurojnë gjithashtu informacion mbi nivelin e jetesës, masën dhe përbërjen e shpenzimeve dhe konsumit total të familjeve dhe karakteristikave socio-ekonomike të tyre. Një nga objektivat specifike e ABEF është marrja e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e peshave të cilat përdoren për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, kjo anketë siguron të dhëna që do të përdoren si një input për matjen e konsumit privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) të familjeve si dhe për analizimin e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda periudhës kohore të përcaktuar.

Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2.400 ekonomi familjare, të zgjedhura sipas metodës së rastit dhe në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është 78 përqind nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABEF është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për ofrimin e të dhënave për Bruto Produktin Vendor (BPV) si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese.

Mostra e ABEF ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe STATA. Pyetësori përmbante informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhëna individuale për secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe konsumin, të ardhurat dhe shpenzimet, kushtet e banimit, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike, etj.

1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2013 - 2015

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike të ABEF për vitet 2013 - 2015. Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga LLK, pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave (si p.sh. të dhëna prej doganave, të dhëna nga importi dhe të dhëna tjera nga prodhimi vendor) dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ). Me një mostër të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta.


1.1 Trendët e konsumit

Tabela 1: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2013 – 2015

Viti	Gjithsej në Milion €	Konsumi për ekonomi familjare €	Konsumi për banor €
2013	2,382	7,625	1,402
2014	2,471	7,611	1,386
2015	2,461	7,503	1,432

Sipas rezultateve të ABEF 2015, kemi rënie prej 0,4 përqind të konsumit të përgjithshëm krahasuar me vitin 2014, po ashtu kemi rënie prej 1,4 përqind në konsum të ekonomive familjare, por kemi rritje prej 3,3 përqind të konsumit për kokë banori.

Graf. 1: Konsumi për kokë banori në vitin 2015, €



1.2 Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2015 është shpenzuar në ushqim dhe banim, 43 përqind për ushqim dhe 30 përqind për banim, të konsumit të përgjithshëm. Pason shpenzimet për transport, veshmbathje, alkohol dhe duhan nga 4 përqind. Në vitin 2015, krahasuar me dy vitet e mëparshme 2013-2014, ushqimi nga prodhimi vetanak në konsumin e përgjithshëm ka shënuar një rritje të vogël, dhe në 2015 është 7 përqind. (Më detalisht është paraqitur në tabelën 2)

Tabela 2: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit 2013– 2015 në %

Konsumi	2013	2014	2015
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	45	44	43
Alkohol dhe duhan	4	4	4
Veshmbathja	4	4	4
Banimi	30	28	30
Mobiliet	3	4	3
Shëndetësi	2	3	3
Transport	4	5	4
Komunikim	2	3	3
Rekreacion	1	0	1
Edukim	1	1	1
Hotel dhe restorante	2	2	2
Të tjera	2	2	2
Ushqimi i vet-prodhuar nga ekonomitë familjare	6	6	7

Ushqimi në Kosovë dominohet nga mishi, qumështi, djathi, vezët, buka dhe drithërat, që kontribuojnë më shumë se gjysmën e konsumit të ushqimit (në vlerë). Më pas radhiten perimet dhe pijet jo alkoolike.

Tabela 3: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2013-2015 në %

Konsumi	2013	2014	2015
Buka dhe drithërat	19	18	17
Mishi	19	20	20
Peshku	2	1	1
Qumështi, djathi, vezët	16	17	18
Vajrat dhe yndyrat	4	3	3
Frutat	7	8	8
Perimet	12	12	12
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	6	6	6
Produkte tjera ushqimore	5	5	5
Pijet joalkoolike	10	10	10
Totali	100	100	100

2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2013–2015

Dihet se konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së popullatës, pra niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien, ndërsa pasuria dhe varfëria varen nga aspekte të tjera në jetë. Të dhënat për konsum merren nga ekonomitë familjare, përdërisa të ardhurat fitohen nga individët. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, argëtimi dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas KKIQ në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK). Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.


Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar, dhe një pjesë më e vogël në mallrat të vetëprodhuara. Periudha e referuar është dy javore për mallra ushqimore (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve), tre muajt e fundit për mallra jo-ushqimore dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme të konsumit (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rumbullakuar që të sinjalojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlera të përafërta.

Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2015 në Kosovë ka qenë 7.503 €, nga kjo vërehet se ka pasur rënie të lehtë prej 1,4 përqind në krahasim me vitin 2014. Në vendbanimet urbane kanë pasur një rënie të konsumit prej 1,8 përqind dhe në ato rurale prej 0,9 përqind.


Graf.2: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013–2015



2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha)

Siç vërehet në Graf.3 pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, alkooli dhe duhani, veshmbathjet dhe transporti) paraqesin 85 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shtatë kategoritë tjera të konsumit e ndajnë 15 përqind të konsumit.


Graf. 3: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit, % e përgjithshme 2013 - 2015



2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike


Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare shfrytëzohet për ushqim dhe pijet joalkoolike dhe është llogaritur 3.202 € për vitin 2015 apo 43 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shpenzimet për ushqim dhe pijet joalkoolike në ekonomitë familjare paraqesin një rënie prej 4,8 përqind krahasuar me vitin 2014.

Graf. 4: Konsumi vjetor i ushqimit dhe pijeve joalkoolike nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit 2013- 2015 në €



Të dhënat e paraqitura në Graf.5 tregojnë se ushqimi dhe pijet joalkoolike përbëjnë komponentin kryesor të konsumit me rreth 43 përqind. Në vitin 2015 shënohet një rënie e vogël e pjesëmarrjes së ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsum në total si dhe në vendbanime urbane dhe ato rurale, prej 4 përqind, krahasuar me vitin 2014.


Graf.5: Pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit 2013 - 2015 në %



2.3 Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 2.221 € apo 30 përqind të buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2015. Shënohet rritje e shpenzimeve për banim në gjitha grupet, në total prej 3,5 përqind, në vendbanime urbane rreth 2 përqind dhe në vendbanime rurale rreth 5 përqind, në krahasim me vitin 2014. Pjesa më e madhe e banimit është “qiraja e vlerësuar”. Një pjesë e vogël e ekonomive familjare paguajnë qira. Ushqimi dhe pijet joalkoolike dhe banimi së bashku përbëjnë rreth tre të katërtat apo 73 përqind të buxhetit të ekonomive familjare.

Graf.6: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015 në €




2.4 Transporti

Transporti në vitin 2015 ka pasur rënie në të gjitha grupet krahasuar me vitin 2014, rreth 7 përqind në total, rreth 8 përqind në vendbanime urbane dhe në ato rurale prej 6 përqind.

Pjesa e buxhetit e ndarë për transport në vitin 2015 ka qenë 4 përqind për ekonomitë familjare urbane dhe 5 përqind për ekonomitë familjare rurale.


Graf.7: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015 në €



2.5 Veshmbathjet

Në vitin 2015 ekonomia familjare mesatarisht ka shpenzuar 318 € për veshmbathje apo 4 përqind të buxhetit në kuadër të buxhetit të përgjithshëm. Në total gjatë viteve 2013–2015 vërehet rritje e vazhdueshme të shpenzimeve të veshmbathjeve. Në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014, në vendbanime urbane ka pasur rënie rreth 2 përqind, ndërsa në ato rurale ka pasur rritje rreth 3 përqind.


Graf.8: Shpenzimet për veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015 në €



2.6 Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë familjare në vitin 2015 alkooli dhe duhani marrin pjesë 4 përqind, apo 308 € në vit. Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 vërehet rënie e shpenzimeve për konsum të alkoolit dhe duhanit prej 2 përqind në total dhe po ashtu edhe në vendbanime rurale, prej 3 përqind. Në vendbanimet urbane shpenzimet për konsum të alkoolit dhe duhanit qëndrojnë konstant gjatë viteve 2014 dhe 2015.

Graf.9: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015, në €



Te duhanpirësit në vitin 2015, vërehet rënie e vogël e konsumimit të tij në total dhe te meshkujt.

Përqindje e duhanpirësve të cilët konsumojnë 11 deri 20 dhe 21+ cigare nuk ka pësuar ndryshim gjatë viteve 2014-2015 në të gjitha grupet.

Tabela 4: Përqindja e duhanpirësve në popullatë në vitin 2014-2015 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve, % e popullatës në moshën 10 vjeçare dhe më të moshuara


Numri i cigareve	Meshkujt (%)		Femrat (%)		Të gjithë (%)	
	2014	2015	2014	2015	2014	2015
1 deri 10	2	1	2	2	2	1
11 deri 20	18	18	4	4	11	11
21+	3	3	0	0	1	1
Përqindja e duhanpirësve	23	22	6	6	14	13

2.7 Mobilitet

Gjatë viteve 2014–2015 vërehet rënie e shpenzime për mobilie në total si dhe në vendbanime urbane dhe rurale. Krahasuar me vitin 2014, në vitin 2015 shënohet rënie në total prej 5 përqind, në vendbanime urbane prej 8 përqind dhe në vendbanime rurale prej 3 përqind.

Në vitin 2015 ekonomia familjare mesatarisht për mobilie ka shpenzuar rreth 264 € në vit.


Graf.10: Mobilitet sipas lokalitetit 2013-2015 në €



2.8 Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësinë në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, dukshëm kanë pasur rënie në të gjitha grupet (në total 15 përqind, në vendbanime urbane 16 përqind dhe në ato rurale 14 përqind).


Graf.11: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015, në €



2.9 Komunikimi

Shpenzimet për komunikim në vitin 2015 kanë qenë 207 € dhe kanë marrë pjesë në ndarjen e buxhetit të përgjithshëm të ekonomisë familjare me 3 përqind. Gjatë viteve 2014-2015 në total dhe në vendbanimet urbane vërehet një rënie e vogël, ndërsa në ato rurale shpenzimet për komunikim kanë mbetur pothuajse të njëjta.

Graf. 12: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015, në €




2.10 Rekreacioni

Niveli i shpenzimeve për rekreacion për ekonomitë familjare në nivel të Kosovës shënon rritje në vitin 2015 në të gjitha grupet.

Në vitin 2015 ekonomitë familjare në vendbanime urbane kanë shpenzuar për rekreacion 50 përqind më shumë se në vitin 2014. Pjesa e ndarë për rekreacion prej buxhetit të përgjithshëm të ekonomisë familjare në vitin 2015 ka qenë 40 €.


Graf.13: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit 2013-2015, në €



2.11 Arsimi

Shpenzimet për arsim në vitin 2015 kanë shënuar rritje në total prej 12 përqind dhe në vendbanimet rurale prej 25 përqind në krahasim me vitin 2014. Në vendbanimet urbane shpenzimet për arsim kanë mbetur pothuajse të njëjta gjatë viteve 2014-2015.


Graf.14: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015, në €



2.12 Hotele dhe restorante

Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, shpenzimet për hotele dhe restorante kanë shënuar rritje në të gjitha grupet. Në vendbanime urbane, pas një rënie në vitin 2014, vërehet rritje prej 9 përqind në vitin 2015. Në vendbanime rurale shpenzimet për hotele dhe restorante kanë rritje konstante gjatë viteve 2013-2015.

Graf.15: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjaresipas lokalitetit 2013-2015, në €




2.13 Mallrat dhe shërbime tjera

Ky grup është një përzierje e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për rregullim të flokëve, mallra për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare.

Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, shënohet rritje të këtyre shpenzimeve në të gjitha grupet (në total rreth 15 përqind, në vendbanime urbane rreth 17 përqind dhe në ato rurale rreth 14 përqind).

Graf.16: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2013-2015, në €



3 Të hyrat private në Kosovë 2014 -2015

3.1 Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Në vitin 2015 rrogat nga sektori publik kanë qenë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë por si burim tjetër i rëndësishëm kanë qenë rrogat nga sektori privat për rreth një të pestën e ekonomive familjare.

Burime tjera të rëndësishme janë pensionet dhe bizneset e ekonomive familjare. Paratë e dërguara nga jashtë (remitencat) janë shumë të vlefshme për rreth 9 përqind të ekonomive familjare.

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

Tabela 5: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare

Burimi i të hyrave	2014	2015
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	22	26
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	30	22
Bujqësi	4	5
Të ardhurat nga mëditjet ¹	7	6
Biznese të tjera të ekonomive familjare	10	11
Pensionet	13	13
Të hollat e dërguara nga jashtë	8	9
Të hollat e dërguara nga Kosova	0	1
Ndihma sociale - Kategori I	3	4
Ndihma sociale - Kategori II	1	1
Të ardhurat nga prona	-	1
Të tjera ²	2	1
Totali në %	100	100

¹ Të hyrat nga aktivitete të përkohshme.

² Të tjera – Burimi i të hyrave jo të përcaktuara në kategoritë më lartë.

3.2 Burimet e të hyrave individuale

Burimi kryesor i të hyrave janë rrogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme.

Burim i dytë janë të hyrat neto nga bizneset që përbëjnë 12 përqind të të hyrave të përgjithshme. Rreth 4 përqind janë fituar nga puna e përkohshme.

Burimi tjetër i rëndësishëm janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë (remitenca) nga pjesëtarët e ekonomive familjare 2 përqind me një shtesë prej 5 përqind nga persona tjerë jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 9 përqind dhe pensionet nga jashtë 3 përqind.

Rrogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt, por të ardhurat nga biznesi vetanak janë më të rëndësishme për meshkujt (me 14 përqind) sesa për femrat (3 përqind).

Pensionet nga Kosova me 17 përqind krahasuar me vetëm 7 përqind për meshkuj përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm të të ardhurave për femrat. Burimi i tretë i rëndësishëm për femrat janë paratë e gatshme nga jashtë me 10 përqind krahasuar me 7 përqind për meshkujt. Burim i rëndësishëm i të hyrave për meshkuj është bujqësia me 14 përqind, ndërsa për femrat vetëm 1 përqind.

Tabela 6: Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2015 (%)

Burimi i të hyrave	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Neto rrogat dhe pagesat fituara në Kosovë në sektorin publik	29	46	33
Neto rrogat dhe pagesat fituara në Kosovë në sektorin privat	17	12	16
Pagat në natyrë	1	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	5	1	4
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	1	0	1
Benefitet për mirëqenie sociale	1	3	2
Pensionet nga Kosova	7	17	9
Pensionet nga jashtë Kosovës	3	3	3
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	0	1	0
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	14	3	12
Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat, transferet, etj)	2	3	2
Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera	5	7	5
Të hyrat nga bujqësia	14	1	11
Të tjera	1	3	2
Totali në %	100	100	100
Totali në milion €	1,625	422	2,048

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak, në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga pensionet, bujqësia dhe mbështetja nga jashtë (remitencat).

Tabela 7: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2015 (%)

Burimi i të ardhurave	Me arsim fillor	Me arsim të mesëm	Me universitet e më të lartë
Pagat nga punësimi i rregullt në sektorin publik	6	27	70
Pagat nga punësimi i rregullt në sektorin privat	9	22	13
Pagat në natyrë	0	1	0
Të ardhurat nga mëditjet	8	4	0
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	1	1	1
Benefitet për mirëqenie sociale	4	1	0
Pensionet nga Kosova	23	4	3
Pensionet nga jashtë Kosovës	7	3	1
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	1	0	0
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	7	17	8
Para të gatshmet dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat,transferet, etj)	3	2	1
Para të gatshme të dërguara nga diaspora nga persona të tjerë	11	4	1
Të hyrat nga bujqësia	18	13	2
Të tjera	2	1	0
Totali në %	100	100	100

3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore

Sa i përket punësimit 12 mujor, femrat dhe meshkujt kanë të hyra të barabarta si mesatare individuale por sipas niveleve të edukimit femrat kanë të hyra më të ulëta në krahasim me meshkujt sidomos vërehet tek femrat me edukim fillor. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta.

Tabela 8: Të ardhurat mesatare vjetore në vitin 2015, sipas gjinisë për të punësuarit me punësim 12 mujor, në €

Të ardhurat	Paga vjetore mesatare e meshkujve me punësim 12 mujor	Paga vjetore mesatare e femrave me punësim 12 mujor	Përqindja e të punësuarëve me punësim 12 mujor
Të ardhurat për punësim 12 mujor	4,028 €	3,135 €	53%
Të punësuarit me arsim fillor 12 mujor	2,694 €	1,380 €	52%
Të punësuarit me arsim të mesëm 12 mujor	3,774 €	3,132 €	53%
Të punësuarit me arsim të lartë 12 mujor	5,645 €	5,171 €	51%

4 Kushtet e jetesës dhe Përballueshmëria

4.1 Pronësia sipas strukturës gjinore dhe nën hipotekë

Tabela 9: Pronësia në vitin 2014-2015 sipas gjinisë, në %

Pronar i shtëpisë (banesës)	2014	2015
Mashkull	91	95
Femër	9	5


Sipas të dhënave të tabelës 9 vazhdon të vërehet tradita që mashkulli të jetë pronar i shtëpisë ose banesës.

Tabela 10: Shtëpitë/banesat nën hipotekë në vitin 2014-2015, në %

Shtëpitë/banesat nën hipotekë	2014	2015
Jo nën hipotekë	97	99
Nën hipotekë	3	1


4.2 Posedimi i dhomave dhe pajisjeve / shërbimeve

Graf.17: Posedimi i dhomave në ekonomi familjare në vitin 2015 , në %




Është dukuri që ekonomitë familjare në shumë raste të përdorin kuzhinën si njërin prej dhomave për shkak të kushteve jo të mira (standardeve).


Graf. 18: Posedimi i pajisjeve/shërbimeve për banim në ekonomi familjare në vitin 2015, në %



¹ Ujin e nxehtë të rrjedhshëm prej ujëngrohësit (bojlerit)

Graf. 19: Posedimi i telefonave mobil (celularë) në ekonomi familjare në vitin 2015, në %




Graf. 20: Posedimi i veturave në ekonomi familjare në vitin 2014-2015, në %

4.3. Përbalueshmëria


Ekonomitë familjare shpesh nuk janë në gjendje të paguajnë në kohë pagesat siç janë qiraja, kreditë, tatimet, shpenzimet komunale -faturat, mirëmbajtje të rregullta etj.

Gjatë vitit 2014, 42 përqind e ekonomive familjare dy herë ose më shumë nuk kanë mundur të përballojnë pagesat, ndërsa në vitin 2015 është vërejtur një rritje prej 1 përqind. Te ekonomitë familjare që një here nuk kanë mundur të përballojnë pagesat është vërejtur një rënie prej 2 përqind në vitin 2015, në krahasim me vitin 2014.

Graf. 21 Jo-përbalueshmëria e pagesave nga ekonomitë familjare, 2014 dhe 2015, në %


Më shumë se gjysma e ekonomive familjare në Kosovë gjatë vitit 2015 kanë deklaruar se nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë një shpenzim të papritur prej 500 € përmes burimeve vetanake.

Graf. 22: Përballueshmëria e një shpenzimi të papritur prej 500 €, 2015 në %




Gjatë vitit 2015, 55 përqind ekonomive familjare nuk ka mundur të mbajë shtëpinë apo banesën të ngrohtë në mënyrë adekuate.

Graf.23: Përballueshmëria e ngrohjes së shtëpisë/banesës në mënyrë adekuate gjatë dimrit, 2015 në %




Graf. 24: Përballueshmëria e një pushimi vjetor njëjavorë jashtë shtëpisë, 2014-2015 në %



Gjatë viteve 2014-2015, 73 përqind të ekonomive familjare nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë një pushim vjetor njëjavorë.

Graf. 25: Përballueshmëria e shujtës me mish, pula, peshqi (ose ushqim vegjetarian), 2014-2015 në %



Më shumë se gjysma e ekonomive familjare në Kosovë në vitin 2015, nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë të ushqyerit çdo të dytën ditë shujtën me mish, pula, peshqi apo ushqim vegjetarian.

5 Konkluzione

Përmes ABEF-it, ASK-ja respektivisht DSS është munduar të plotësoj vakum në mungesë të informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare dhe Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare është e mirëseardhur për ofrimin e këtyre të dhënave. Qëllimi kryesor i këtij raporti është vlerësimi i konsumit të ekonomive familjare, të ardhurat dhe kushtet e jetesës në nivel vendi për vitin 2015. Ky raport pasqyron të dhëna për vitet 2013-2015.

Analizat e ABEF 2015 tregojnë se në Kosovë konsumi i përgjithshëm ka pasur rënie të vogël prej 0,4 % dhe 1,4 % tek konsumi për ekonomi familjare, ndërsa rritje për kokë banori për 3,3 %. (Tabela 1). Ekonomitë familjare në Kosovë pjesën më të madhe të konsumit e kanë shpenzuar për ushqim, banim, alkool dhe duhan, veshmbathje dhe transport. (Tabela 2). Tek shpërndarja e ushqimit në konsum në vitin 2015 dominon mishi, qumështi, djathi dhe vezët, buka dhe drithërat dhe perimet (Tabela 3).

Në konsumin e familjes kosovare është i rëndësishëm konsumi vetanak me 7 %.

Te ekonomitë familjare urbane dominon konsumi për ushqim, banim, alkooli dhe duhani, veshmbathje dhe transport, ndërsa tek ato rurale dominon konsumi për ushqim, banim, veshmbathje, transport, alkool dhe duhan (Tabela A1).

Ekonomitë familjare në të cilat kryefamiljari ka arsim të lartë krahasuar me ato ku ai ka shkollim të mesëm, fillor apo më pak pothuajse në të gjitha grupe po e ndajnë pjesën e buxhetit më shumë (Tabela A1).

Pjesë e këtij raporti janë edhe burimi kryesor i të hyrave të ekonomive familjare dhe të hyrave individuale (Kapitulli 3). Sipas rezultateve të ABEF 2015 burim më i rëndësishëm i të hyrave të ekonomive familjare janë rrogat nga sektori publik dhe ai privat, pastaj të hyrat nga pensionet, biznesi vetanak dhe po ashtu të hollat e dërguara nga jashtë (Tabela 5).

Siç vërehet në Tabelën 6 Burimet e të hyrave individuale, pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë rrogat nga punësimi i rregullt që përfaqësojnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme, ndërsa burimi i dytë janë të hyrat nga bizneset. Po ashtu rol të rëndësishëm kanë edhe pensionet, bujqësia dhe paratë e dërguara nga jashtë (remitencat).

Te të hyrat individuale vërehet se personat me arsim më të lartë burim kryesor e kanë pasur punësimin e rregullt, ndërsa ata me arsim fillor apo më pak orientoheshin tek pensionet, bujqësia, mbështetja nga jashtë, mëditjet dhe biznesi vetanak. (Tabela 7)

Në bazë të të dhënave të kushteve të jetesës (Kapitulli 4), ekonomitë familjare në vitin 2015 mesatarisht posedojnë 3 dhoma në përdorim (Graf 17). Vetëm 11 përqind posedojnë sistem të ngrohjes qendrore, lidhje telefonike posedojnë pothuajse një e pesta e ekonomive familjare ndërsa lidhje interneti 70 përqind dhe kompjuter/lloptop 71 përqind (Graf 18).

43 përqind e ekonomive familjare dy herë ose më shumë gjatë vitit nuk kanë qenë në gjendje të paguajnë në kohë pagesat e tyre, 60 përqind të ekonomive familjare kanë përballuar me vështirësi të mëdha një shpenzim të papritur në vlerë të 500€ përmes burimeve vetanake.

6 Shtojcat

6.1 Tabela A1: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2013-2015 sipas lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % e konsumit të përgjithshëm

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilie	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreacion	Arsim	Hotele dhe restorante	Të tjera	Totali €
Kosovë													
2013	3 394	307	310	2 279	253	169	312	202	35	38	148	179	7 625
2014	3 366	313	316	2 146	278	241	357	209	30	33	149	173	7 611
2015	3 202	308	318	2 221	264	205	333	207	40	37	169	199	7 503
Urbane													
2013	3 248	316	281	2 792	239	168	297	246	47	32	229	155	8 050
2014	3 277	323	308	2 548	283	250	335	244	34	40	207	193	8 041
2015	3 103	323	302	2603	260	211	309	238	51	39	229	226	7 894
Rurale													
2013	3 506	300	332	1 884	264	169	323	168	26	42	85	198	7 297
2014	3 433	305	322	1 840	274	233	374	183	27	28	105	157	7 281
2015	3 274	297	330	1 940	267	201	350	184	32	35	126	179	7 215
Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak													
2013	3 270	307	328	1 944	236	184	261	167	16	31	64	168	6 974
2014	3 177	336	283	1 801	245	252	269	161	19	18	70	137	6 768
2015	3 017	300	309	1 942	246	252	256	165	26	23	102	166	6 805
Kryefamiljari me arsim të mesëm													
2013	3 380	314	286	2 271	255	159	313	207	29	40	131	174	7 560
2014	3 358	300	295	2 167	285	233	370	219	27	37	151	176	7 618
2015	3 190	327	290	2222	260	170	335	208	38	39	155	197	7 431
Kryefamiljari me arsim të lartë													
2013	3 760	288	330	3 179	295	157	441	280	104	47	414	222	9 515
2014	3 848	297	464	2 922	333	235	530	296	69	57	335	249	9 635
2015	3 691	271	424	2 905	319	194	512	305	81	62	377	288	9 430

6.1 Tabela A2: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2013-2015, sipas 5 grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në % (vazhdim)

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilie	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreacion	Arsim	Hotele dhe restorante	Të tjera	5 grupet kryesore ¹ %
Kosovë													
2013	45	4	4	30	3	2	4	2	1	1	2	2	87%
2014	44	4	4	28	4	3	5	3	0	1	2	2	85%
2015	43	4	4	30	3	3	4	3	1	1	2	2	85%
Urbane													
2013	40	4	3	35	3	2	4	3	1	0	3	2	86%
2014	41	4	4	32	4	3	4	3	0	0	3	2	85%
2015	39	4	4	33	3	3	4	3	1	0	3	3	84%
Rurale													
2013	48	4	5	26	4	3	4	2	0	1	1	3	87%
2014	47	4	5	25	4	3	5	3	0	1	1	2	86%
2015	45	4	5	27	4	3	5	3	0	0	2	2	86%
Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak													
2013	47	5	5	28	3	3	4	3	0	0	1	2	89%
2014	47	5	4	27	4	4	4	2	0	0	1	2	87%
2015	44	4	5	29	4	4	4	2	0	0	2	2	86%
Kryefamiljari me arsim të mesëm													
2013	45	4	4	30	3	2	4	3	0	1	2	2	87%
2014	44	4	4	29	4	3	5	3	0	0	2	2	86%
2015	43	4	4	30	4	2	5	3	1	1	2	3	86%
Kryefamiljari me arsim të lartë													
2013	40	3	4	35	3	2	5	3	1	1	4	2	87%
2014	40	3	5	30	3	2	6	3	1	1	3	3	84%
2015	39	3	5	31	3	2	5	3	1	1	4	3	83%

¹ Këtu janë përfshirë pesë grupet kryesore të konsumit (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathjet, alkooli dhe duhani)

6.2 Metodologjia në të shkurtër

Mostrimi, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

PERIUDHA	Janar – Dhjetor 2015
DIZAJNIMI I MOSTRËS	2400 ekonomi familjare në 300 qarqe regjistruese; 200 ekonomi familjare për muaj. Mostra është e stratifikuar në dy faza, me Regjistrimin e Popullsisë 2011 si kornizë për fazën e parë. Mostra është e stratifikuar sipas rajoneve dhe urban-rural, 14 shtresa.
INTERVISTIMI I KRYER ME SUKSES SIPAS MOSTRËS	1868 ekonomi familjare prej mostrës bazë plus 476 ekonomi familjare të zëvendësuara.
SHKALLA E PËRGJIGJEVE	78 % prej mostrës bazë
ORARI I INTERVISTIMEVE	Në çdo qark regjistruer, 4 ekonomi familjare marrin pjesë gjatë gjysmës së parë të muajit dhe 4 gjatë pjesës së dytë. Çdo ekonomi familjare duhet të shënoj shpenzimet e ushqimit gjatë javës së parë dhe gjatë javës së dytë. Java e dytë në fakt mund të mbulojë 8 ose 9 ditë. Familja vizitohet tre herë - para periudhës së intervistimit, pas një jave, dhe në fund të periudhës.
PESHAT	Peshat janë përshtatur, ku një qark regjistruer kishte përgjigje nga më pak se 8 ekonomi familjare.
PERIUDHA E REFERIMIT	Për produktet ushqimore, periudha e referimit është dy javë (gjysma e muajit). Blerjet, dhuratat si dhe prodhime të veta të ushqimit janë kyçur. Për mallrat gjysmë afatgjata (jo-ushqimore), blerjet dhe dhuratat gjatë tre muajve të fundit janë të regjistruar, për mallra afatgjata në 12 muajt e fundit. Para 2012, periudha e referimit për produktet ushqimore ishte një muaj.
INFORMATAT TË TJERA	Në pyetësin e ABEF-it kemi përfshirë disa pyetje prej SILC-modulit: Përballueshmëria si dhe pyetjet lidhur me shpenzimet e shëndetësisë (në institucione shëndetësore publike dhe private dhe ato brenda dhe jashtë shtetit).

Kalkulimet

Shpenzimet janë të organizuara në 12 kategoritë përcaktuara nga COICOP, klasifikimi ndërkombëtar i Konsumit Individual sipas Qëllimit. Disa detaje të këtij klasifikimi janë dhënë më poshtë. (Detajet e plota mund të gjenden në internet në <http://unstats.un.org/UNSD/cr/registry/regcst.asp?Cl=5&Lg=1>

COICOP-KATEGORIA E KONSUMIT	Disa detaje në lidhje me artikuj në çdo kategori
1 USHQIMI	Bukë, mish, vaj, fruta, perime, qumësht, djathë, vezë, pije jo-alkoolike, kafe, çaj, produkte sheqeri, ushqimi i marrur si dhuratë, konsumi vetanak etj.
2 PIJE ALKOOLIKE DHE DUHANI	Pije alkoolike (alkoolike dhe likeret, verë, birra) Duhani (Cigare, puro, duhani tjetër)
3 VESHMBATHJE	Veshje për burrat dhe gratë, mbathje për burrat dhe gratë, aksesore, riparimin etj.
4 BANIMI	Qiraja dhe qiraja e vlerësuar, materiale për mirëmbajtje dhe riparim, shërbim për mirëmbajtje, ujësjellës, elektrikë, dru zjarri dhe lëndë djegëse të tjera, takëm, gota, enë kuzhine, pajisje të vogla elektronike, pajisjet kryesore për shtëpi dhe kopsht, etj.
5 MOBILIE	Perde, jastëkë, jorgan, batanije, çarçafë, të tjera (çanta, mbulesa tavoline, peshqira, flamuj, çadër dielli), shtretër, sofa, kolltukë, karrige, tryezë, tavolinë, piktura dhe objekte të tjera të artit, tepiha leshi apo këmbësore, tepison, tepiha tjerë dhe shtrojë dyshemeje (jo banjë), riparimi i artikujve të tillë, frigorifer dhe ngrirës frigorifer, mjete elektrike shtëpiake, makina larëse dhe thithëse, pastrimi me avull dhe makina shkumuese, riparimi i pajisjeve shtëpiake (ndërrimet dhe materiale), etj.
6 SHËNDETËSIA	Medikamentet, pajisje farmaceutike, pajisje terapeutike, shërbimet jashtë-spitalore në institucionet publike dhe private shëndetësore, dentistët në institucionet publike dhe private shëndetësore, analiza mjekësore, radioskopi (rëntgen) në institucionet publike dhe private shëndetësore, shërbimet shëndetësore në spitalet publike ose në klinikat e QKUK dhe në spitalet private, strehimi, ushqimi, dhe transporti (me ambulancë) që lidhet me shërbimet shëndetësore në Kosovë dhe jashtë vendit, strehimi, ushqimi dhe transporti (me ambulancë) që lidhet me trajtimin jashtë Kosovës, mjekësia tradicionale, shërbime të tjera mjekësore.
7 TRANSPORTI	Benzinë, gazi, naftë për motorët, pjesë rezervë dhe pajisje, mirëmbajtje dhe riparim, blerja e automjeteve të vjetra dhe të reja, garazhë dhe parking, taksit dhe të ngjashme, bileta aeroplani, bileta autobusi dhe bileta e kombinuar etj.
8 KOMUNIKIMI	Shërbimet postare, shërbime telefonike (fiks dhe mobil), shërbime të tjera (fax, Internet) etj.
9 REKREACIONI	Lodrat, lojëra, hobi, pajisjet për sport, kopshte, bimë, lule, shtazë shtëpiake dhe prodhimet për to, veterinaria dhe shërbimet tjera për kafshë shtëpiake, kinema, teatro, koncerte, muzetë, kopshtet zoologjike, etj, kompjuter, libra, gazetat, botime periodike, letër dhe materiale për vizatime, materiale për shtypje, lojëra te fatit (lotaria), shërbime të tjera etj.
10 ARSIMIMI	Trajnimi me kompjuter, trajnimi në gjuhë të huaja, arsimi parashkollor dhe fillor (klasa 1-5), arsimi i ulët i mesëm (klasa 6-9), arsimi i mesëm i lartë (klasa 10-13), arsimi universitar, arsimi i pa definuar sipas niveleve.
11 HOTELE DHE RESTORANE	Hotele, restorane, bufetë, pako aranzhime për pushime etj..
12 MALLRA TË TJERA	Prerja dhe rregullimi i flokëve, pajisjet elektrike për kujdes personal, sigurimet, strehimet për pleqë dhe të paafatë, shërbime juridike dhe administrative, etj.

Për një ekonomi familjare të caktuar i , shpenzimet vjetore T_i llogariten si më poshtë:

$T_i = (\text{shuma e të gjitha shpenzimeve të ushqimit}) * 2 + (\text{shuma e të gjitha shpenzimeve të mallrave gjysmë afatgjata}) * 4 + (\text{shuma e shpenzimeve për mallrat e qëndrueshme})$.

Pastaj, secili T_i shumëzohet me peshë w_i . Pesa duhet të jetë e barabartë me numrin e ekonomive familjare që janë të përfaqësuara nga familje të specifikuar të përfshira në mostër. Të gjitha ekonomitë familjare në një qark regjistruar kanë të njëjtën peshë. Shuma $\sum w_i T_i$ për këtë arsye është një vlerësim i shpenzimeve totale vjetore në fushën ose kategori mbuluar nga mbledhja. $\sum w_i$ është numri totali vlerësuar i ekonomive familjare (në të njëjtën qark ose kategori), $\sum w_i T_i / \sum w_i$ janë shpenzimet mesatare për ekonomi familjare. Për të marrë shpenzimet mesatare vjetore për kokë banori, $\sum w_i T_i / \sum w_i$ është e ndarë me numrin mesatar të anëtarëve për familje.

Shuma dhe mesataret pikërisht të njëjtit lloj janë llogaritur gjithashtu për çdo kategori **COICOP** veç e veç.

Saktësia e të dhënave

Ekonomitë familjare mostër janë përdorur për të llogaritur vlerësimet e shpenzimeve (etj) për të gjitha ekonomitë familjare. Nëse mostra është mjaft e madhe, dhe të zgjedhur në mënyrë shkencore, pasiguria e vlerësimeve në përgjithësi do të jetë e vogël. Pasiguria shpesh shprehet me një interval besueshmërie. Vlera e vërtetë për të gjithë popullsinë pastaj pritet të jetë diku në mes të kufirit të besimit të ulët dhe të sipërm, me një probabilitet të lartë (këtu 95%).

Intervalet e besimit për disa nga variabilet kryesore në ABEF janë si më poshtë:

Të dhënat	Vlerësim	Kufiri më i ulët i besimit	Kufiri më i lartë i besimit
Konsumi i përgjithshëm, milion €	2 461	2 392	2 530
Konsumi i përgjithshëm i produkteve ushqimore, milion €	1 050	1 018	1 082
Konsumi vjetor per ek.familjare, €	7 503	7 309	7 697
Konsumi vjetor per ek.familjare urbane, €	7 894	7 588	8 200
Konsumi vjetor per ek.familjare rurale, €	7 215	6964	7465
Konsumi vjetor I ushqimirt për ek.familjare, €	3 202	3 114	3 290
Pjesëmarrja e ushqimit, Kosova, %	42,6	41,9	43,4
Pjesëmarrja e ushqimit, urbane, %	39,3	38,3	40,2
Pjesëmarrja e ushqimit,rurale, %	45,3	44,3	46,4

Në përgjithësi, vlerësimi në nivel kombëtar mund të pritet që të ketë kufijtë e besimit të rreth 2-3% (të vlerësimit) më poshtë dhe mbi vlerën e parashikuar. Vlerësimet për zonat urbane ose rurale mund të pritet që të ketë kufijtë e rreth 3-4% më poshtë dhe mbi vlerën e parashikuar.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

64.01(496.51)“2015”(047)

Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2015 / Publikimin
e përgatitën Bashkim Bellaqa...[et al.]
. – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016. - 36 f. : ilustr. me ngjyra
; 28 cm. – (Seria 5: Statistikat Sociale)

Parathënie / Isa Krasniqi : f. [1]

1.Bellaqa, Bashkim

ISBN 978-9951-22-267-9

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenei Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-267-9



9 789951 222679